

Vendim nr. 63, datë 02.06.2026

(V- 63/26)

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Fiona Papajorgji, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Sonila Bejtja, Sandër Beci, Genti Ibrahimimi, Marjana Semini, Asim Vokshi, Ilir Toska, anëtarë, me sekretare Farisja Idrizaj, në datën 02.06.2026 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 24 (D) 2025 të Regjistrisë Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **DASHMIRA ZARO**

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e ankimit të veçantë nga Gjykata Administrative e Apelit.
Konstatimi i mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit.
Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për përshpejtimin e gjykimit të çështjes nr. 31138-02088-86-2025, të regjistruar në datën 03.07.2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6, pika 1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*Ligji Organik i Gjykatës*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, mori në shqyrtim pretendimet e kërkueses Dashmira Zaro (*kërkuessa*), e cila ka kërkuar pranimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesja është palë paditëse në çështjen administrative, me objektin e saktësuar të padisë: “1. Konstatimin e cenimit të gëzimit të lirë dhe paqësor të pronës për shkak të ndërhyrjes arbitrare të organit publik Autoriteti Rrugor Shqiptar pa pasur vendim shpronësimi dhe urdhërimin e këtij organi për të kthyer pronën në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e tij. 2. Urdhërimin e të paditurit, Autoritetit Rrugor Shqiptar, të më paguajë dëmshpërblimin për 1/6 pjesë takuese me vlerën e plotë të tokës. 3. Urdhërimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastrë të më pajisë me certifikatë pronësie”. Kjo çështje është regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë në datën 16.01.2025.

2. Në seancën përgatitore të datës 28.03.2025, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë ka shpallur moskompetencën lëndore për kërkimin e parë të padisë së kërkueses, duke urdhëruar dërgimin e akteve për gjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë. Po ashtu, me vendimin e ndërmjetëm nr. 1744 (31138-00054-89-2025) akti, datë 28.03.2025, ajo gjykatë ka vendosur edhe pezullimin e gjykimit të çështjes administrative deri në zgjidhjen, me vendim gjyqësor të formës së prerë, të kërimit të veçuar të padisë për shkak të moskompetencës lëndore. Kundër këtij vendimi kërkuesja ka paraqitur ankim të veçantë dhe çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit me nr. 31138-02088-86-2025, datë 03.07.2025.

3. Në datën 08.07.2025 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e gjykimit të çështjes. Kërkesa është refuzuar nga gjyqtari relator i çështjes në datën 02.09.2025 dhe kërkuesja, pas kërkesës për informacion, është njoftuar në rrugë elektronike në datën 03.09.2025.

4. Në vijim, në datën 22.09.2025, përmes shërbimit postar, kërkuesja ka depozituar në Gjykatën Administrative të Apelit një kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe urdhërimin e përshpejtimin të gjykimit të çështjes së saj nga ajo gjykatë. Për këtë kërkesë, kërkuesja, më pas, ka kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë, e cila, në rrugë elektronike, në datën 18.11.2025, e ka njoftuar se nga verifikimet e kryera nuk rezultonte që kërkesa të ishte regjistruar pranë saj.

5. Pas këtij informacioni, në datën 25.11.2025, kërkuesja ka paraqitur ankim kushtetues individual në Gjykatën Kushtetuese (*Gjykata*), sipas objektit. Ky ankim, pasi është plotësuar në përputhje me parashikimet e Ligjit Organik të Gjykatës, është regjistruar në datën 09.12.2025.

6. Ndërkohë, pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual nga kërkuesja, rezulton se Gjykata Administrative e Apelit ia ka dërguar Gjykatës së Lartë kërkesën e kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, e cila është regjistruar pranë kësaj të fundit në datën 12.12.2025. Në vijim, pas shqyrtimit të saj, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 00-2026-137, datë 22.01.2026, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së kërkueses. Sipas Gjykatës së Lartë, mosveprimi i Gjykatës Administrative të Apelit nuk ka ndodhur për shkaqe subjektive që lidhen me vlerësime ose qëndrime abuzive të gjyqtarit relator, por për shkak të pamundësisë objektive të asaj gjykate për të gjykuar çështjen brenda një afati të arsyeshëm, në kushtet e një ngarkese të lartë pune si pasojë e akumulimit ndër vite të dosjeve gjyqësore. Nga ana tjetër, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se gjyqtari relator ka detyrimin që të mbajë në konsideratë shqyrtimin me përparësi të kategorive të caktuara të çështjeve për të cilat ligji procedural ka përcaktuar afate të posaçme, për shkak të natyrës së tyre. Për rastin konkret, ajo ka çmuar se, për shkak të natyrës së vendimit të kundërshtuar, çështja duhej të mbahej në vëmendje të veçantë nga gjyqtari relator, duke orientuar gjykimin e saj brenda një afati 2-mujor nga marrja dijeni për vendimin e Gjykatës së Lartë.

7. Kolegji i Gjykatës, pas shqyrtimit paraprak të ankimit kushtetues individual të kërkueses në datën 09.02.2026, ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

8. Pas kalimit të çështjes për shqyrtim në seancë plenare, sipas informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr. 4424/1 prot., datë 20.05.2026, rezulton se çështja e kërkueses është shqyrtuar dhe ajo gjykatë, me vendimin nr. 1079 (86-2026-1220), datë 23.04.2026, ka vendosur prishjen e vendimit të ndërmjetëm nr. 1744 (31138-00054-89-2025) akti, datë 28.3.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë dhe kthimin e çështjes në të njëjtën gjykatë, për vijimin e gjykimit të saj.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

9. **Kërkuesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

- 9.1. *E drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, pasi Gjykata Administrative e Apelit ka tejkaluar afatin 30-ditor të parashikuar në nenin 471/a të Kodit të Procedurës Civile (KPC) në lidhje me gjykimin e ankimit të veçantë të paraqitur kundër vendimit të pezullimit nr. 1744 (31138-00054-89-2025) akti, datë 28.03.2025 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë. Ky ankim duhet të ishte shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar bazuar edhe në Kreun II, pika 3.1, shkronja “e”, të vendimit nr. 78, datë 30.05.2019 (vendimi nr. 78/2019) të Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGJ), duke marrë parasysh edhe moshën 79-vjeçare të kërkueses. Megjithatë, gjyqtari relator i çështjes nuk e mori parasysh kërkesën e saj për përshpejtimin e çështjes. Vonesa e gjykimit të ankimit të veçantë për pezullimin e gjykimit i cenon kërkueses të drejtën për ushtrimin e ankimit së bashku me vendimin përfundimtar për atë pjesë të padisë për të cilën është shpallur moskompetenca lëndore nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë.
- 9.2. *E drejta për një mjet ligjor efektiv*, pasi kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit, e paraqitur në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 22.09.2025, nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë brenda afatit 45-ditor të përcaktuar në nenin 399/7, pika 2, të KPC-së. Për më tepër, sipas informacionit të Gjykatës së Lartë, kërkesa nuk rezultonte të ishte regjistruar pranë saj. Kjo situatë nuk ka ardhur për shkak të mospërmbushjes prej kërkueses të ndonjë detyrimi ligjor, por për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të autoriteteve gjyqësore. Për rrjedhojë, mjeti i përdorur nuk ka qenë efektiv, për sa kohë nuk ka arritur të përshpejtojë gjykimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimin e kërkueses

10. Çështja e legjitimit (locus standi) është një ndër aspektet kryesore që lidhen me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të Ligjit Organik të Gjykatës, çdo individ mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo vendimi gjyqësor që cenon

të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të Ligjit Organik të Gjykatës, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike efektive, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

11. Gjykata vlerëson se kërkuësja, si bartëse e të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi është palë ndërgjyqëse në procesin gjyqësor ndaj të cilit ka ngritur pretendime në Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

12. Për sa i përket kriterit të *shterimit të mjeteve juridike efektive*, të parashikuar nga neni 131, pika 1, shkronja “f”, i Kushtetutës dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i Ligjit Organik të Gjykatës, kërkuësja ka paraqitur ankim kushtetues individual, duke ngritur pretendime për kohëzgjatjen e gjykimit në Gjykatën e Apelit Administrativ, por edhe për mungesën e efektivitetit të mjeteve të parashikuara nga KPC-ja për mbrojtjen e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

13. Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) ka pranuar se neni 13 i KEDNJ-së i lejon një shteti të zgjedhë midis një mjeti “parandalues ose përshpejtues”, të projektuar për të përshpejtuar procedurat në mënyrë që të parandalojë që ato të tejzgjasin dhe një mjeti “riparues, kompensues ose monetar”, që parashikon korrigjimin *ex post facto* për vonesat që kanë ndodhur tashmë, qoftë edhe nëse procedura është ende në shqyrtim. Ligjvënësi shqiptar ka parashikuar një zgjidhje të kombinuar përshpejtuese/parandaluese dhe kompensuese në nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Ky mekanizëm është vlerësuar, në parim, si efikas edhe nga GJEDNJ-ja, pasi mund të parandalojë vijimësinë e shkeljes së pretenduar të së drejtës së individit që çështja e tij të dëgjohet pa vonesa të tepërta, si dhe të garantojë korrigjimin e duhur për shkeljet që kanë ndodhur (*shih vendimet nr. 74, datë 24.12.2025; nr. 58, datë 17.09.2024; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuësja në datën 22.09.2025 ka përdorur mjetin parandalues/përshpejtues të parashikuar nga KPC-ja. Megjithatë, kërkesa e saj nuk është shqyrtuar brenda afatit 45-ditor nga paraqitja, sikurse përcakton neni 399/7, pika 2, i KPC-së, ndërsa, në vijim, është rrëzuar me vendimin e Gjykatës së Lartë të datës 22.01.2026, me arsyetimin

se tejzgjatja e gjykimit kishte ardhur për shkaqe objektive, të pavarura nga vullneti i gjyqtarit relator. Në fakt, ankimi i veçantë është shqyrtuar vetëm në datën 23.04.2026, kur Gjykata Administrative e Apelit ka vendosur prishjen e vendimit të ndërmjetëm të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë për pezullimin e gjykimit dhe kthimin e çështjes për vijimin e gjykimit në atë gjykatë. Në këto rrethana, ndonëse mjeti i përdorur nga kërkuesja kishte natyrë përshpejtuese, ai nuk ka arritur të parandalojë vijimin e vonesës në Gjykatën Administrative të Apelit. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kërkuesja nuk kishte më mjete juridike efektive në dispozicion, përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Kërkuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ankimi kushtetues individual është paraqitur brenda afatit ligjor 4-mujor nga konstatimi i shkeljes së pretenduar, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të Ligjit Organik të Gjykatës. Në rastin konkret, në momentin e paraqitjes së ankimit kushtetues, shkelja e pretenduar vijonte. Për më tepër, ankimi është paraqitur në datën 25.11.2025, pra pasi kishte kaluar afati 45-ditor brenda të cilit, sipas nenit 399/7, pika 2, të KPC-së, Gjykata e Lartë duhej të kishte shqyrtuar kërkesën e kërkueses për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, të paraqitur në datën 22.09.2025. Vendimi i mëvonshëm i Gjykatës së Lartë, me të cilin kërkesa e kërkueses është rrëzuar, nuk e ndryshon këtë përfundim, për sa kohë ai nuk ka sjellë riparimin ose ndërprerjen e shkeljes së pretenduar. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se kriteri i legjitimitetit *ratione temporis* është përmbushur.

16. Për sa i përket legjitimitetit *ratione materiae*, kërkuesja ka pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt ligjor në drejtim të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm. Ky pretendim hyn në juridiksionin kushtetues, në kuptim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj do të analizohet në vijim.

B. Për themelin e pretendimeve

B. 1. Për cenimin e së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm

17. Kërkuesja ka pretenduar se çështja e saj lidhet me ankimin e veçantë të paraqitur kundër vendimit të ndërmjetëm të gjykatës administrative të shkallës së parë për pezullimin e gjykimit, çështje e cila është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 03.07.2025, por që nuk është shqyrtuar brenda afatit 30-ditor të parashikuar nga neni 471/a i KPC-së. Sipas kërkueses, ankimi i veçantë i saj duhej të ishte shqyrtuar me procedurë të përshpejtuar, bazuar edhe në vendimin nr. 78/2019 të KLGJ-së, duke marrë parasysh moshën 79-vjeçare të saj. Po sipas saj, ndonëse ajo ka

kërkuar përshpejtimin e gjykimit të çështjes, gjyqtari relator e ka refuzuar kërkesën e saj. Nga ana tjetër, sipas kërkueses, vonesa në shqyrtimin e ankimit të veçantë kundër vendimit të pezullimit i cenon të drejtën për ushtrimin e ankimit së bashku me vendimin përfundimtar për atë pjesë të padisë për të cilën është shpallur moskompetencë lëndore nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Lushnjë.

18. Neni 42 i Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se kushdo për mbrojtjen e të drejtave të tij kushtetuese dhe ligjore ka të drejtën e një gjykimi brenda një afati të arsyeshëm. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e gjykimit, normalisht, llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor deri në dhënien e vendimit dhe se në kohëzgjatjen e përgjithshme të gjykimit nuk përjashtohen vonesat e shkaktuara nga zbatimi i reformës në drejtësi, pasi barra e këtyre vonesave nuk duhet të zhvendoset te palët ndërgjyqëse (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 57, datë 17.09.2024; nr. 33, datë 01.11.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Në rastin konkret, Gjykata vëren se procesi gjyqësor është vënë në lëvizje nga kërkuesja në datën 16.01.2025. Padia e paraqitur prej saj, përmbante tre kërtime, për njërin prej të cilëve ajo gjykatë ka vlerësuar se ishte i natyrës civile dhe, për këtë shkak, ka shpallur moskompetencën lëndore, duke ia dërguar aktet gjykatës kompetente civile. Ndërkohë, për kërkimet e tjera të mbetura për shqyrtim prej saj, ajo gjykatë ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në zgjidhjen, me vendim gjyqësor të formës së prerë, të kërimit për të cilin ishte shpallur moskompetenca lëndore. Pikërisht kundër vendimit të ndërmjetëm të pezullimit të gjykimit kërkuesja ka paraqitur ankim të veçantë, mbi bazën e të cilit çështja është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 03.07.2025. Ndonëse në datën 22.09.2025 kërkuesja ka kërkuar konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, Gjykata e Lartë, në datën 22.01.2026, ka vendosur rrëzimin e kërkesës. Së fundi, pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin e datës 23.04.2026, ka vendosur prishjen e vendimit të ndërmjetëm të pezullimit dhe kthimin e çështjes për vijimin e gjykimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë.

20. Lidhur me afatet e gjykimit të mosmarrëveshjeve administrative, neni 48 i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*) parashikon afatin 30-ditor për shqyrtimin e çështjes nga Gjykata Administrative e Apelit. Po kështu, për ankimet e veçanta kundër vendimeve të ndërmjetme, sikurse në rastin në

shqyrtim, i njëjti afat përcaktohet edhe nga neni 470, pika 3, i KPC-së, i zbatueshëm në çështjet administrative në bazë të nenit 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012.

21. Nga sa më sipër, Gjykata konstaton se shqyrtimi i ankimit të veçantë të kërkueses në Gjykatën Administrative të Apelit ka zgjatur më shumë se 9 muaj nga regjistrimi i tij në atë gjykatë, duke tejkaluar dukshëm afatin ligjor 30-ditor. Për këtë arsye, fillimisht, duhet vlerësuar nëse përfundimi i këtij gjykimi, pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, e bën kërkesën pa objekt dhe, nëse jo, nëse kohëzgjatja e konstatuar përbën tejzgjatje të paarsyeshme në kuptim të jurisprudencës kushtetuese.

22. Për çështjen e parë, Gjykata çmon se kërkesa nuk mbetet pa objekt vetëm për shkak se, pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual, Gjykata Administrative e Apelit ka përfunduar shqyrtimin e ankimit të veçantë, në rrethanat kur kërkuësja nuk ka kërkuar vetëm përshejtimin e gjyqimit, por edhe konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Gjykata ka pohuar se qëllimi parësor i mjeteve juridike për shkeljen e afatit të arsyeshëm është njohja e shkeljes dhe parandalimi i zgjatjes në mënyrë të tepruar të afatit të procesit përmes përshejtitimit të tij dhe, kur është rasti, korrigjimi i vonesave të ndodhura përmes shpërblimit të dëmit (*shih vendimet nr. 74, datë 24.12.2025; nr. 11, datë 28.02.2025 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këto kushte, kërkuësja ruan interesin kushtetues për shqyrtim në themel të ankimit kushtetues individual, pasi konstatimi i shkeljes, nëse ajo provohet, mund t'i shërbejë kërkueses për rivendosjen e së drejtës së cenuar në aspektin kompensues, sipas rregullimeve ligjore përkatëse.

23. Në lidhje me çështjen e dytë, Gjykata ka theksuar se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave, në kuptim të rrethanave të veçanta të çështjes konkrete, vlerësohet nën dritën e këtyre kritereve: (i) sjellja e kërkueses; (ii) kompleksiteti i çështjes; (iii) sjellja e autoriteteve; (iv) rëndësia e asaj çfarë rrezikon kërkuësja (*shih vendimet nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 68, datë 07.12.2023; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

24. Për sa u përket kritereve që lidhen me sjelljen e kërkueses, kompleksitetin e çështjes dhe sjelljen e autoriteteve, Gjykata, bazuar në qëndrimin e saj të konsoliduar për vlerësimin e tyre (*shih vendimet nr. 61, datë 21.10.2025; nr. 15, datë 03.04.2025; nr. 57, datë 17.09.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), nuk konstaton në rastin konkret rrethana që të justifikojnë një qëndrim të ndryshëm.

Për rrjedhojë, për vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së procesit, Gjykata do të ndalet në vijim të rëndësia e asaj që rrezikon kërkesja për shkak të vonesës në shqyrtimin e çështjes së saj.

25. Në jurisprudencën kushtetuese është theksuar se disa çështje që lidhen me interesa “vetjakë e jetësorë” kërkojnë trajtim me shpejtësi e përparësi, ku si të tilla janë, ndër të tjera, çështjet që lidhen me statusin civil, kujdestarinë e fëmijëve, marrëdhëniet e punësimit, sëmundjet e pashërueshme, pensionin etj., edhe pse kjo listë nuk mund të jetë shteruese dhe interesi i kërkuarit verifikohet rast pas rasti (*shih vendimet nr. 43, datë 04.06.2024; nr. 21, datë 04.04.2024; nr. 6, datë 16.02.2023 të Gjykatës Kushtetuese*). Nga ana tjetër, kur kohëzgjatja e gjykimit ka qenë e konsiderueshme, Gjykata ka konstatuar shkelje të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm edhe në rastet që nuk kërkonin domosdoshmërisht trajtim me përparësi, siç janë mosmarrëveshjet për të drejtën e pronës të lidhura me procesin e kthimit dhe kompensimit të pronave (*shih vendimin nr. 46, datë 03.10.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Në rastin në shqyrtim, Gjykata vëren se çështja e themelit, e vënë në lëvizje nga kërkesja, ka të bëjë me pretendimin për shpërblimin e pasurisë që ajo pretendon se i është marrë nga shteti. Edhe pse kjo çështje nuk lidhet drejtpërdrejt me interesa jetësorë që kërkojnë, në çdo rast, trajtim me përparësi, ajo lidhet me të drejtën e pronës. Për më tepër, gjykimi i çështjes së themelit është pezulluar pikërisht për shkak të vendimit të ndërmjetëm ndaj të cilit kërkesja ka paraqitur ankim të veçantë. Mosshqyrtimi i këtij ankimi brenda afatit ligjor ka sjellë, për pasojë, mosvijimin e gjykimit të çështjes së themelit. Gjykata vëren, gjithashtu, se kërkesja i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me kërkesë për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes, duke parashtruar edhe moshën e saj të avancuar. Në këto rrethana, duke marrë në konsideratë natyrën e çështjes, ndikimin e vendimit të pezullimit në ecurinë e gjykimit të themelit dhe interesin konkret të kërkuarës, Gjykata vlerëson se çështja kërkonte trajtim me përparësi dhe shpejtësi të veçantë nga Gjykata Administrative e Apelit.

27. Për më tepër, referuar edhe qëndrimit të GJEDNJ-së, Gjykata është shprehur se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të konsiderohet kohë e arsyeshme dhe se palët në mosmarrëveshjet civile, edhe kur çështja nuk kërkon ndonjë trajtim të veçantë prioritar, kanë megjithatë të drejtën, sipas nenit 6, pika 1, të KEDNJ-së, për një proces brenda një afati të arsyeshëm, pa qenë të detyruara të tregojnë, për këtë qëllim, se u është shkaktuar ndonjë dëm i veçantë ose shtesë nga vonesat procedurale. Gjykata ka theksuar gjithashtu se një periudhë e gjatë mosveprimi nuk mund të justifikohet vetëm me reformën në sistemin e drejtësisë ose me ngarkesën e krijuar për gjyqtarët për shkak të saj. Faktorë të tillë, me natyrë të përgjithshme, mund të merren në konsideratë

në një masë të përshtatshme gjatë vlerësimit të kohëzgjatjes së procedurave, por nuk janë, në vetvete, të mjaftueshëm për të justifikuar vonesa të konsiderueshme (*shih vendimin nr. 54, datë 09.10.2025 të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Në këtë këndvështrim, Gjykata, duke pasur parasysh se çështja administrative e vënë në lëvizje nga kërkuesja është prej më shumë se 16 muajsh në shqyrtim përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Lushnjë, si dhe faktin se shqyrtimi i ankimit të veçantë ndaj vendimit të pezullimit në Gjykatën Administrative të Apelit ka zgjatur më shumë se 9 muaj, arrin në përfundimin se kërkueses i është cenuar e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës. Megjithatë, në kushtet kur shqyrtimi i ankimit të veçantë tashmë ka përfunduar, nuk ka më vend për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2026-137, datë 22.01.2026 të Gjykatës së Lartë, as për urdhërimin e Gjykatës Administrative të Apelit që ta shqyrtojë çështjen me përparësi. Për rrjedhojë, Gjykata çmon se duhet të kufizohet në konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, konstatim i cili i krijon asaj mundësinë të kërkojë korrigjimin e shkeljes sipas rregullimeve ligjore përkatëse.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Konstatimin e cenimit të së drejtës së kërkueses për gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata e Apelit Administrativ, në çështjen administrative nr. 31138-02088-86-2025, datë regjistrimi 03.07.2025.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 02.06.2026

Shpallur më 01.07.2026

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes me kërkuese Dashmira Zaro, me objekt: *“Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e ankimit të veçantë nga Gjykata Administrative e Apelit. Konstatimi i mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit. Urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për përshpejtimin e gjykimit të çështjes nr. 31138-02088-86-2025, të regjistruar në datën 03.07.2025”*, ne, gjyqtarët Ilir Toska dhe Genti Ibrahim, ndajmë qëndrim të ndryshëm nga shumica, pasi vlerësojmë se kërkesa duhej të ishte rrëzuar.

2. Shumica ka mbajtur qëndrimin se mjeti juridik i përdorur nga kërkuësja, ndonëse kishte natyrë përshpejtuese, nuk ka arritur të parandalojë vijimin e vonesës në Gjykatën Administrative të Apelit dhe, për rrjedhojë, kërkuësja nuk kishte më mjete juridike efektive në dispozicion, përveç ankimit kushtetues individual (*shih paragrafin 14 të vendimit*). Po ashtu, shumica ka vlerësuar se përfundimi i shqyrtimit të ankimit të veçantë nga Gjykata Administrative e Apelit pas paraqitjes së ankimit kushtetues individual nuk e bënte kërkesën pa objekt, pasi kërkuësja kishte kërkuar edhe konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm (*shih paragrafin 22 të vendimit*). Në vijim, shumica ka konsideruar se shqyrtimi i ankimit të veçantë pas më shumë se 9 muajsh nga regjistrimi i tij në Gjykatën Administrative të Apelit, krahasuar me afatin ligjor 30-ditor, dhe duke mbajtur parasysh natyrën e çështjes, pezullimin e gjykimit të themelit dhe moshën e kërkuëses, përbënte tejzgjatje të paarsyeshme të gjykimit (*shih paragrafët 21, 26 dhe 28 të vendimit*).

3. Në vlerësimin tonë, ndonëse vonesa në shqyrtimin e ankimit të veçantë nuk është e dëshirueshme dhe tejkalimi i afatit ligjor 30-ditor është i dukshëm, kjo rrethanë, e marrë e vetme, nuk mjafton për të arritur në përfundimin se kërkuëses i është cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Afati 30-ditor është afat procedural ligjor, respektimi i të cilit është i rëndësishëm për mirëfunksionimin e procesit, por nuk është kufiri i vetëm dhe përcaktues për konstatimin e cenimit kushtetues të afatit të arsyeshëm. Ky i fundit përbën standard kushtetues dhe nuk barazohet me çdo afat procedural të parashikuar në ligj. Përkundrazi, referuar jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së, ai kërkon vlerësim konkret të të gjitha rrethanave të çështjes, duke përfshirë natyrën e mosmarrëveshjes, kompleksitetin e saj, sjelljen e palëve, sjelljen e autoriteteve dhe rëndësinë e asaj që rrezikon kërkuësja.

4. Në këtë drejtim, në vlerësimin tonë, duhej mbajtur parasysh se kohëzgjatja e arsyeshme, në aspektin ligjor, është rregulluar nga neni 399/2 i KPC-së, sipas të cilit, në gjykimin administrativ në shkallë të parë dhe në apel gjykimi konsiderohet i zhvilluar brenda afatit të arsyeshëm nëse përfundon brenda një viti nga fillimi i tij në secilën shkallë. Është e vërtetë se kjo dispozitë i referohet gjykimit administrativ në themel, ndërsa në rastin konkret bëhet fjalë për shqyrtimin e një ankimi të veçantë ndaj një vendimi të ndërmjetëm për pezullimin e gjykimit. Megjithatë, kjo dispozitë nuk mund të lihet jashtë vëmendjes në vlerësimin kushtetues të afatit të arsyeshëm, për sa kohë ankimi i veçantë nuk përbën një proces të pavarur nga gjykimi i themelit, por një fazë të ndërmjetme brenda tij.

5. Kjo qasje, në vlerësimin tonë, pajtohet edhe me jurisprudencën e GJEDNJ-së, sipas të cilës, arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurave që përfshihen në fushën e nenit 6, paragrafi 1, të Konventës, duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, të cilat duhet të vlerësohen në tërësi (*shih Frydlender kundër Francës [DhM], 2000, §43*). Po ashtu, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se vonesa të ndryshme, edhe kur asnjëra prej tyre, e marrë veçmas, nuk duket se ngre ndonjë problem, duhet të shqyrtohen nëse, të marra së bashku dhe në mënyrë kumulative, kanë bërë që të tejkalohet afati i arsyeshëm (*shih Deumeland kundër Gjermanisë, 1986, §90*). Nga ana tjetër, një vonesë në një fazë të caktuar mund të jetë e pranueshme nëse kohëzgjatja e përgjithshme e procedurave nuk mund të konsiderohet e tepruar (*shih Kolomojets kundër Ukrainës, 2010, §49*). Në mënyrë më specifike për procedurat e ndërmjetme para gjykatave të zakonshme, GJEDNJ-ja ka vlerësuar se, duke supozuar se ato duhet të shqyrtohen sipas nenit 6, paragrafi 1, të Konventës, kohëzgjatja prej rreth 7 muajsh për tri shkallë juridiksioni ishte e pranueshme (*shih Hofmann kundër Gjermanisë, kërkesa nr. 71475/01, vendim për pranueshmërinë, datë 25.09.2007*).

6. Në rastin konkret, ankimi i veçantë i kërkueses është regjistruar në Gjykatën Administrative të Apelit në datën 03.07.2025 dhe është shqyrtuar në datën 23.04.2026. Pra, shqyrtimi i tij ka zgjatur më shumë se 9 muaj. Edhe pse kjo kohëzgjatje tejkalon afatin procedural 30-ditor, ajo duhet parë në kontekstin e faktit se ankimi i veçantë përbënte një mjet procedural të ndërmjetëm brenda procesit të themelit dhe lidhej me një vendim të ndërmjetëm, të dhënë gjatë një procesi gjyqësor ende në vijim. Për rrjedhojë, vlerësimi kushtetues nuk mund të kufizohet te krahasimi i thjeshtë mes afatit ligjor dhe kohës reale të shqyrtimit, por duhet të përcaktojë nëse vonesa, në rrethanat konkrete, kishte arritur atë nivel ashpërsie që e bënte shqyrtimin e ankimit të veçantë të paarsyeshëm në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës.

7. Po kështu, në vlerësimin tonë, duhej mbajtur parasysh se çështja e themelit lidhej me të drejtën e pronës dhe me pretendimin e kërkueses për shpërblim për pasurinë që ajo pretendon se i është marrë nga shteti. Kjo natyrë e mosmarrëveshjes është padyshim e rëndësishme, por, megjithatë, ajo nuk përfshihet në kategorinë e atyre çështjeve që kanë të bëjnë me interesa vetjakë dhe jetësorë që, sipas jurisprudencës kushtetuese, kërkojnë domosdoshmërisht trajtim me përparësi të posaçme. Edhe mosha e kërkueses, ndonëse është element që mund të merret në konsideratë, nuk mjafton, në mungesë të rrethanave të tjera konkrete, për ta shndërruar vonesën në shqyrtimin e ankimit të veçantë në cenim kushtetues.

8. Për më tepër, në vlerësimin tonë, nuk mund të lihej pa peshë fakti se vonesa në shqyrtimin e ankimit të veçantë ka ndodhur në kushtet e ngarkesës së lartë të Gjykatës Administrative të Apelit, si pasojë e akumulimit ndër vite të dosjeve dhe pasojave të reformës në drejtësi. Natyrisht, këto rrethana, referuar edhe jurisprudencës kushtetuese dhe asaj të GJEDNJ-së, nuk mund të shërbejnë, në vetvete dhe në çdo rast, si justifikim i mjaftueshëm për vonesat gjyqësore. Megjithatë, ato nuk mund të mos merren fare parasysh në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes së gjykimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për vonesë disamujore në shqyrtimin e një ankimi të veçantë brenda një procesi ende në zhvillim dhe jo për një periudhë shumëvjeçare mosveprimi të autoriteteve gjyqësore.

9. Në këtë drejtim, duhej të mbahej parasysh edhe ecuria konkrete procedurale e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Nga aktet rezulton se gjatë periudhës nga regjistrimi i çështjes në datën 03.07.2025 deri në shqyrtimin e saj në datën 23.04.2026, ajo gjykatë nuk ka qëndruar tërësisht pasive. Gjatë muajit mars të vitit 2026, dy gjyqtarë relatorë, njëri pas tjetrit, pasi kanë studiuar aktet e dosjes gjyqësore, kanë paraqitur kërkesa për heqjen dorë nga shqyrtimi i çështjes për shkaqe papajtueshmërie. Këto kërkesa janë pranuar dhe, në vijim, çështja, me short, i është ngarkuar një gjyqtari tjetër. Ky i fundit, pasi ka përgatitur çështjen dhe pasi është realizuar njoftimi i palëve, të paktën 15 ditë përpara seancës, e ka shqyrtuar atë në vijim. Këto rrethana tregojnë se vonesa nuk ka ardhur si rezultat i pasivitetit të plotë të gjykatës, por edhe për shkak të zhvillimeve procedurale të lidhura me garantimin e paanshmërisë së trupit gjykues dhe respektimin e rregullave të njoftimit të palëve.

10. Po ashtu, në vlerësimin e arsyeshmërisë së kohëzgjatjes nuk mund të lihet jashtë vëmendjes mënyra konkrete e organizimit të punës së gjykatës gjatë periudhës në shqyrtim. Kjo periudhë ka përfshirë edhe kohën gjatë së cilës gjyqtarët e Gjykatës Administrative të Apelit,

sikundër të gjithë gjyqtarët e tjerë të sistemit gjyqësor, ushtrojnë të drejtën për pushim vjetor, i cili sipas ligjit është 25 ditë pune dhe, në terma kalendarikë, përfaqëson rreth pesë javë. Në vlerësimin tonë, ky element nuk shërben për të përjashtuar ose justifikuar në vetvete tejkalimin e afatit procedural, por për të vlerësuar nëse, në kushtet konkrete të funksionimit të gjykatës, ky tejkalim arrinte nivelin e një shkeljeje kushtetuese të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

11. Në këtë kuadër, rëndësi merr edhe fakti se kërkesja e ka përdorur mjetin e posaçëm të parashikuar nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së. Është e vërtetë se kërkesa e saj, e paraqitur në datën 22.09.2025 në Gjykatën Administrative të Apelit, nuk është shqyrtuar nga Gjykata e Lartë brenda afatit 45-ditor të parashikuar nga neni 399/7, pika 2, i KPC-së, pasi është regjistruar pranë kësaj të fundit vetëm në datën 12.12.2025. Megjithatë, kjo rrethanë, në vlerësimin tonë, nuk mjafton për të arritur në përfundimin se mjeti ligjor ka qenë joefektiv në kuptimin kushtetues. Gjykata e Lartë, ndonëse ka vendosur rrëzimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, nuk ka qëndruar indiferente ndaj situatës procedurale të kërkeses. Ajo ka shqyrtuar pretendimin e saj dhe ka orientuar Gjykatën Administrative të Apelit që, për shkak të natyrës së vendimit të kundërshtuar, ta mbante çështjen në vëmendje të veçantë dhe ta shqyrtonte brenda një afati 2-mujor nga marrja dijeni për vendimin. Ky element tregon se mjeti i përdorur nga kërkesja nuk ka mbetur thjesht formal, por ka sjellë një vlerësim gjyqësor të pretendimit për vonesë dhe një orientim konkret për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes.

12. Po ashtu, në vlerësimin tonë, duhet mbajtur parasysh se Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar ankimin e veçantë pas vendimit të Gjykatës së Lartë dhe para përfundimit të gjykimit kushtetues. Edhe pse shqyrtimi nuk është realizuar brenda afatit 2-mujor të orientuar nga Gjykata e Lartë, ai është kryer në një periudhë të afërt pas këtij orientimi, duke marrë parasysh ngarkesën e gjykatës, zhvillimet procedurale të lidhura me ndryshimin e gjyqtarëve relatorë për shkaqe papajtueshmërie, nevojën për përgatitjen e çështjes nga relatori i ri, si dhe respektimin e afateve të njoftimit të palëve. Në këto kushte, nuk mund të thuhet se autoritetet gjyqësore kanë mbetur pasive ose se mjeti i përdorur nga kërkesja ka qenë i paaftë për të ndikuar në ecurinë e procesit.

13. Gjithashtu, përfundimi i shqyrtimit të ankimit të veçantë nga Gjykata Administrative e Apelit merrte rëndësi në përcaktimin nëse vonesa e konstatuar arrinte nivelin e një shkeljeje kushtetuese. Në vlerësimin tonë, për sa kohë ankimi i veçantë tashmë ishte shqyrtuar dhe kërkimi

për përshpejtimin e gjykimit kishte mbetur praktikisht pa objekt, kjo vonesë nuk krijonte, në vetvete dhe në rrethanat konkrete të çështjes, konstatimin e cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Kjo nuk përjashton që vonesa në shqyrtimin e ankimit të veçantë të merret parasysh, nëse është rasti, në vlerësimin e mëvonshëm të kohëzgjatjes së procedurës gjyqësore në tërësi ose të pasojave konkrete që ajo mund të ketë sjellë për kërkuesen.

14. Për sa më lart, në vlerësimin tonë, afati i arsyeshëm, si standard kushtetues, nuk mund të përcaktohet vetëm nga tejkalimi i afatit procedural 30-ditor, por kërkon vlerësimin e rrethanave konkrete të çështjes. Në rastin konkret, kohëzgjatja e shqyrtimit të ankimit të veçantë, karakteri i tij si mjet procedural i ndërmjetëm brenda procesit të themelit, fakti se çështja e themelit është ende në gjykim, përdorimi i mjetit ligjor përshpejtues, orientimi i dhënë nga Gjykata e Lartë, ecuria procedurale e çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit, si dhe shqyrtimi tashmë i përfunduar i ankimit nga kjo gjykatë, nuk krijojnë bazë të mjaftueshme për të arritur në përfundimin se kërkueses i ishte cenuar e drejta kushtetuese për gjykim brenda një afati të arsyeshëm.

15. Për këto arsye, mbajtëm qëndrimin se kërkesa e kërkueses duhej të ishte rrëzuar.

Anëtarë: Ilir Toska, Genti Ibrahim

MENDIM PAKICE

1. Në shqyrtimin e çështjes që i përket kërkesës së kërkueses Dashmira Zaro, me objekt konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm në gjykimin e ankimit të veçantë nga Gjykata Administrative e Apelit; konstatimi i mungesës së një mjeti ligjor efektiv për përshpejtimin e gjykimit; urdhërimi i Gjykatës Administrative të Apelit për përshpejtimin e gjykimit të çështjes nr. 31138-02088-86-2025, të regjistruar në datën 03.07.2025, unë, gjyqtari Asim Vokshi, jam kundër vendimit të shumicës për pranimin e kërkesës, për arsyet e mëposhtme.

2. Pakica vlerëson se Gjykata mund të konstatojë shkelje të afatit të arsyeshëm, pasi të shterohet më parë rruga normale e ankimit dhe të thotë fjalën e vet juridiksioni i zakonshëm, konform parimit të subsidiaritetit. Si rregull, pretendimi për shkelje të afatit të arsyeshëm ngrihet fillimisht pranë gjykatës së zakonshme që është “në vonesë”, e cila ia përcjell aktet dhe mendimin e gjyqtarit relator gjykatës kompetente për shqyrtimin e këtij kërkit, e cila e shqyrton çështjen brenda 45 ditëve. Gjykata nuk konstatoi cenim të kohëzgjatjes, që mori shqyrtimi i kërkesës së kërkueses sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së (shiko dispozitat në tërësinë e tyre), pranë Gjykatës së Lartë, e cila në datën 22.01.2026 rrëzoi kërkesën e kërkueses për konstatim të cenimit të afatit të arsyeshëm të gjykimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit dhe përshpejtimin e gjykimit, por u fokusua te kohëzgjatja e shqyrtimit pranë Gjykatës Administrative të Apelit. Gjykata, duke regjistruar çështjen në datën 09.12.2025, pa u shprehur më parë Gjykata e Lartë, e cila kishte paralelisht në shqyrtim kërkitin e kërkueses sipas nenit 399/1 të KPC-së, ka marrë në shqyrtim një çështje që nuk kishte hyrë ende në juridiksionin kushtetues. Në këtë mënyrë Gjykata Kushtetuese nuk ishte kompetente për shqyrtimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit, pa u ankuar njëkohësisht pala edhe për vendimarrjen e Gjykatës së Lartë, konform tagrave kushtetues të përcaktuar shprehimisht nga neni 131, shkronja “f”, i Kushtetutës.

3. Pra, pa thënë fjalën e vet Gjykata e Lartë, duke e pasur ajo çështjen në gjykim, konform kompetencës që i njeh shprehimisht neni 399/6, pika 2, shkronja “b”, i KPC (shih dispozitën) dhe pa konstatuar Gjykata antikushtetutshmërinë e kësaj dispozite ligjore, ajo nuk mund të merre kompetencat e gjykatave të zakonshme dhe të vendoste vetë konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, pa pasur objekt të ankimit kushtetues vendimin e datës 22.01.2026 të Gjykatës së Lartë që rrëzonte kërkesën e kërkueses sipas neneve 399/1 e vijues të KPC-së, por drejtpërdrejt ankimin për kohëzgjatjen e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit.

4. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për konstatimin e shkeljes së afatit nga Gjykata Administrative e Apelit është i paefektshëm, pasi në datën 20.05.2026 Gjykata Administrative e Apelit e ka shqyrtuar tashmë çështjen për të cilën është ngritur pretendimi për cenimin e kohëzgjatjes së arsyeshme. Vendimarrja deklarative e Gjykatës është e paefektshme, pasi ajo nuk i shërben dot kërkueses as për marrjen e ndonjë “kompensimi” financiar. Që ajo të legjitimohet në këtë kërkit, duhet që sipas paragrafit të dytë të nenit 399/4 të KPC-së (shih dispozitën) të ketë një vendimarrje për konstatim shkeljeje dhe përshpejtim procedure, e cila të ketë rezultuar e

paefektshme, pasi nuk është ekzekutuar nga organi që ka kryer shkeljen. Domethënë, mekanizmi është dizenuar që vetëm kur dështon përsheptimi të aktivizohet dëmshpërblimi monetar, çka në rastin e kërkuësës nuk ekziston, pasi çështja e saj është zgjidhur para se të bëhej konstatimi nga Gjykata, e cila në çdo rast duhet mbajtur parasysh se nuk është “gjykatë kompetente”, sipas kuptimit të paragrafit të parë të nenit 399/4 të KPC-së (shih dispozitën), ndaj vendimi i saj nuk mund të sjellë efektet për dëmshpërblim financiar (sidomos kur bëhet shqyrtimi i çështjes para shterimit të juridiksionit të zakonshëm gjyqësor). Ndaj Gjykata duhej të kishte vendosur moskalimin për shqyrtim të kësaj çështjeje, pasi kërkuësja nuk kishte shteruar, në kohën e paraqitjes së ankimit kushtetues, mjetet e zakonshme të ankimit sipas ligjit, të cilat ishin potencialisht të afta të adresonin problematikën e saj. Për këto arsye nuk pajtohem me këtë vendimmarrje të sotme të Gjykatës.

Anëtar: Asim Vokshi